

VENDIM
Nr.25, datë 11.1.2012

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË GARËS, TË DOKUMENTEVE
STANDARDE DHE STRUKTURËS SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE,
PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR LOTARINË KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 27 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të vlerësimit të garës, të dokumenteve standarde dhe strukturës së Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, për dhënien e licencës për lotarinë kombëtare, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha